



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIA KAMËZ

Nr 190 prot.

Kamëz, më 23.12 .2020

VENDIM

Nr 169 Datë 23/12/2020

PËR

“MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TË BASHKISË KAMËZ DHE NDËRMARRJEVE TË VARTËSISË PËR VITIN 2021”.

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. **23.12.2020**, në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmara për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin **nr.152 dt 17.12.2020**,

Në mbështetje të nenit 54, të Ligjit nr. nr. **139/2015**, “Per Veteqeverisjen Vendore” të VKM-së nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të te nepunesve civil e te punonjesve administrativ te njesive te qeverisjes vendore” i ndryshuar me V.K.M nr.177 date 08.03.2017, „ të nenit 14 të Ligjit nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar;” Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë”, Ligji nr. 10 296, dt. 08.07.2010 , “Per Menaxhimin financiar dhe kontrollin“, në Ligjin nr. 68/2017 dt. 27/04/2017“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” ne VKM nr. 717, date 23,06,2009 “Per pagat e punonjesve mbeshtetes ne institucionet buxhetore“, i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Miratimin e nivelit të pagave bazuar në V.K.M nr 165 dt 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të te nepunesve civil e te punonjesve administrativ te njesive te qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM-në nr.177, datë 08.03.2017, sipas Lidhjes II bashkëlidhur .
2. Miratimin e nivelit të pagave bazuar në VKM-së nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të te nepunesve civil e te punonjesve administrativ te njesive te qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM-në nr.177, datë 08.03.2017, në VKM nr. 717 date 23,06,2009 “Per pagat e punonjesve mbeshtetes ne institucionet buxhetore“, i

ndryshuar, per Ndermarrjen e Pastrim Gjelberimit dhe Ndermarrjen e Sherbimeve Publike sipas Lidhjes II & VIII bashkëlidhur.

3. Pagat e punonjësve administrative, të jenë deri në masën 39.000 (tridhjetë e nente mijë) lekë në muaj sipas pikës 19, të VKM-së te sipercituar.
4. Këshilltarët e Këshillit Bashkiak Kamëz, të shpërblehen në masën 10 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Kamëz, ndërsa kryetarët e fshatrave dhe ndihmës administratorët e qytetit të shpërblehen në masën 5 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë, ndërsa për kryetarët e fshatrave të Njësise Administrative Paskuqan do të jete 8.2 % e pages se Administratorit.
5. Miratimin e pagave për punonjësit që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit, të përfitojnë një shtesë, sipas pikës 9 të VKM-së të VKM-së te sipercituar.
6. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 01.01.2021.
7. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

K R Y E T A R

MERITA PRENGA

